



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 3599/12 Prot.,

Tiranë më, 31.07.2024

URDHËR

NR. 401, DATË 31.07.2024

PËR

**MIRATIMIN E STATUTIT TË FEDERATËS SHQIPTARE TË QITJES
SPORTIVE**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 16, të ligjit nr. 79/2017 “Për sportin”, i ndryshuar dhe urdhrin nr. 564 datë 5.10.2023, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, z. Endrit Hoxha”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e statutit të Federatës Shqiptare të Qitjes Sportive, propozuar me vendimin nr. 01, datë 02.02.2024, të Asamblesë së Përgjithshme të federatës sportive, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri (21 faqe).
2. Federata Shqiptare e Qitjes Sportive, të ndjekë procedurat e regjistrimit të statutit pranë gjykatës kompetente, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.
3. Statuti ekzistues i Federatës Shqiptare të Qitjes Sportive, i miratuar me urdhrin nr. 174, datë 18.03.2019, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për miratimin e statutit të Federatës Shqiptare të Qitjes Sportive” shfuqizohet.
4. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Drejtorja e Përgjithshme e Zhvillimit të Sportit, Drejtorja e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin dhe Sportin dhe Federata Shqiptare e Qitjes Sportive.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTRI

ENDRIT HOXHA

